



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 687 Prot.

Tiranë, më datë 01.07.2020

VENDIM
Nr. 172, datë 09.06.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim “**Lagja romake-bizantine jashtë mureve të castrum Scampis (Elbasan). Bazilika paleokristiane jashtë mureve**” drejtuar nga Dr. Elio Hobdari (IA), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Sondazh jashtë ndërtesës, ngjitur me murin jugor;
 - Sondazh në nefin jugor, ngjitur me stilobatin e harkadës ndarëse të nefeve në një pikë që do të zgjidhet në mënyrë që të mos ndërhyjë në mbetje të arkitekturës. Ky i dyti synohet të bëhet vetëm për të përcaktuar thellësinë dhe natyrën e themelit të stilobatit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2020;
3. Në rastet kur parashikohen ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre, dhe të shoqërohen me projekt konsolidimi/konservimi/restaurimi pranë IKTK;
4. Të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së lista e inventarit të gjetjeve me qëllim grumbullimin, informimin/ regjistrimin sipas rastit dhe ekspozimin e tyre në Muze;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

